



Tiranë më 21.03.2025

TERMAT E REFERENCES

Monitorues për monitorimin e vendimeve gjyqësore

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka filluar zbatimin e projektit: “Përmirësim i cilësisë së drejtësisë me qasje të orientuar nga mbrojtja dhe mbështetja e viktimave të dhunës seksuale, duke përdorur monitorimin dhe ndërgjegjësimin si mjete ndryshimi”.

Në kuadrin e projektit do të kryhet një monitorim i vendimeve gjyqësore objekt monitorimi në Sarandë (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm), Lezhë (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm) dhe Gjykatën e Apelit. Në kuadrin e zbatimit të këtij projekti është planifikuar të angazhohmë tre monitorues për monitorimin e vendimeve gjyqësore mbi veprat penale të krimeve seksuale.

Zbatimi i projektit do të ketë ndikim tek gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe 13 Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të ndahen me Këshillin e Lartë Gjyqësor, 61 Bashkitë e vendit, Mekanizmat e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje dhe me organizata anëtare të Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore;

Objektivat e projektit:

Objektivi i Përgjithshëm: Të kontribuojë për një sistem drejtësie më cilësor për viktimat e dhunës seksuale;

Objektiva Specifikë:

1) Të përmirësojë cilësinë e drejtësisë përmes përdorimit të rekomandimeve të monitorimit të vendimeve gjyqësore mbi krimet seksuale, të rrisë ndërgjegjësimin dhe përgjegjshmërinë e gjyqtarëve dhe profesionistëve të sistemit.

2) Të rrisë ndërgjegjësimin e anëtarëve të komunitetit, mbi drejtësinë cilësore dhe orientimin e saj për nga të drejtat e viktimave, mbrojtjes dhe mbështetjes së tyre.

Me qëllim përmbushjen e objektivit 1 është planifikuar të organizohet aktiviteti: 1.1. Angazhimi i juristëve për monitorimin e vendimeve gjyqësore mbi veprat penale të krimeve seksuale;

Për kryerjen e monitorimit stafi i projektit i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare do të kërkojë mbështetjen e KLGJ për të pasur akses në vendimet gjyqësore të formës së prerë të Gjykatës së Apelit dhe vendimet

gjqësore objekt monitorimi në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe Lezhë.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e monitoruesëve:

-Mbështesin stafin e projektit për të përgatitur kërkesën për akses në vendimet gjyqësore për çështjet objekt monitorimi në gjykatat objekt monitorimi;

-Ndjekin trajnimin për monitorues që do të organizojë QNL;

-Mbështesin me mbledhjen e vendimeve gjyqësore në gjykatat objekt monitorimi;

-Monitoruesit monitorojnë vendimet gjyqësore bazuar në skedën e monitorimit të përgatitur nga ekspertët e angazhuar në projekt. Skeda do tju shërbejë monitoruesëve për monitorimin e vendimeve gjyqësore me objektin si më lart dhe monitorimi do të kryhet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Gjykatën e Apelit.

-Regjistrojnë të dhënat në excel të gjetjeve nga monitorimi i vendimeve gjyqësore në gjykatat objekt monitorimi;

-Përgatisin tabela dhe grafikë, bazuar në gjetjet e monitorimit;

-Dorëzojnë një përmbledhje të draft gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore nga monitorimi, të cilat do ti përcillen ekspertëve që do të angazhohen të shkruajnë raportin e monitorimit;

Monitoruesit do të ndajnë për monitorim vendimet gjyqësore në bazë të gjykatës së monitoruar dhe/ose në varësi të numrit total të vendimeve gjyqësore të mbledhura nga të gjitha gjykatat objekt monitorimi.

Për kryerjen e monitorimit të vendimeve gjyqësore është planifikuar të angazhohen tre monitorues. Numri i ditëve të punës për secilin monitorues është 15 ditë pune.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare inkurajon aplikimet nga kandidatë, të cilët janë të interesuar për t'u angazhuar si monitorues në këtë proces, kanë përvoja të mëparshme dhe plotësojnë këto kriteret si vijon:

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

Edukimi dhe aftësitë profesionale

-Të kenë përfunduar studimet për Drejtësi niveli Master + Bachelor ose programin e integruar për Drejtësi;

-Të kenë përvoja të mëparshme me monitorimin e zbatimit të legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore, përmes monitorimit të vendimeve gjyqësore, seancave gjyqësore, praktikave, etj.

-Të ketë aftësi analitike në kryerjen e monitorimit me qëllim identifikimin e arritjeve dhe problematikave;

Aftësitë individuale

- Aftësi të shkëlqyera komunikimi;

- Aftësitë e punës në grup, kapaciteti për t'iu përgjigjur pozitivisht reagimeve kritike dhe një qasje e orientuar nga konsensusi ndaj punës.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe me integritet;
- Të ketë aftësi të gjera analitike dhe të menduarit kritik;
- Të jetë përgjegjës për respektimin e detyrave dhe afateve të përcaktuara;

Aplikantët duhet të dorëzojnë në adresën e emailit avokatore2@yahoo.com ose në adresën postare Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Rr. “Vaso Pasha”, P.12, Shk.1, Ap.1, Tiranë **dokumentet si vijon:**

1. OFERTA TEKNIKE:

1.1. Diplomën e studimeve për drejtësi (Bachelor + Master) ose Diplomën e përfundimit të studimeve për Drejtësi Programi i integruar.

1.2. CV (Curriculum Vitae), ku përfshihen përvoja të mëparshme në fushë;

1.3. Raporte monitorimi ose artikuj/studime bazuar në monitorim, që provojnë përvojën e aplikantit në monitorime të zbatimit të legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore.

2.OFERTA FINANCIARE

2.1. Ofertën financiare në Euro për një ditë pune

dhe

2.2. Oferta financiare për 15 ditë pune në total,

Kujdes: Në ofertën financiare për një ditë pune dhe ofertën financiare për 15 dite pune të përfshihen të gjitha kostot e përbushjes së detyrave të cituara më lart.

Do të vlerësohen ofertat financiare vetëm të aplikantëve që përbushin specifikimet teknike, pra: -kanë kryer studimet për drejtësi (Bachelor + Master) ose programin e integruar për Drejtësi; dhe kanë paraqitur cv ku përfshihen përvoja të mëparshme në këtë fushë dhe kanë paraqitur Raporte monitorimi ose artikuj/studime bazuar në monitorimin e legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore.

Në lidhje me vlerësimin me pikë, oferta teknike vlerësohet nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit me maksimumi 80 pikë gjithsej dhe oferta financiare me maksimumi 20 pikë gjithsej, totali 100 pikë.

Nëse nga konkurimi rezultojnë aplikantë me pikë të barabarta, për monitorimin në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe Lezhë, preferencë në përzgjedhje do të kenë aplikantët që kanë një përvojë pozitive bashkëpunimi me organizatat “Jona” në Sarandë dhe “Gruaja tek Gruaja” në Shkodër, organizata partnere në projektin që po zbatohet nga QNL.

* I gjithë dokumentacioni, njoftimet, vendimet, informacionet dhe komunikimet e parashikuara në këtë rregullorë realizohen në formë shkresore. Komunikimi me ofertuesit realizohet me anë të adresës së emailit zyrtar të QNL-së.

** Nuk do të shqyrtohen ofertat e paraqitura nga kandidatët që kanë dërguar ofertat jashtë afatit të thirrjes së parashikuar në kërkesën për ofertë.

***Përzgjedhja do të bëhet mbi bazën e një vlerësimi objektiv, të paanshëm dhe meritokratik të CV-ve dhe çdo formë ndërhyrjeje apo komunikimi paraprak me anëtarët e stafit do të rezultojë në përjashtimin automatik të përzgjedhjes së ekspertit/es.

Lutemi dërgoni dokumentacionin e kërkuar deri më datë 2 Prill 2025.

Për çdo pyetje në lidhje me angazhimin e monitoruesit, ju mund të na shkruani në adresën e emailit avokatore2@yahoo.com deri më datë 27 Mars 2025.

Për angazhimin, me ekspertin/in monitorues do të lidhet një kontratë shërbimi.

Ju faleminderit!

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare